



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER RIDVANA G. RUÇI
ADRESA KAJO KARAFILI
TEL: 683030361**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2195

Nr. koleksioni: 1039

Tirane më 11/04/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025053240086065742





A2025033240086065742

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH ME TE DREJTE RIBLERJE

Sot, më datë 11.04.2025, para meje Notere RIDVANA G. RUÇI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, KAJO KARAFILI, u paraqit personalisht:

PALA SHITËSE:

Z. Enver MEHMETI, i biri i Skënder, i datëlindjes 22.08.1962, shtetas Shqiptar, banues në Rr."Dalip Peza", Durres, Shqipëri, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr. 035957983, Nr. Personal G20822071P, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i shoqërisë "**Premier Group**" sh.p.k. me NUIS L51819501O, që zotëron 1 (një) kuotë që përkon me 40% të kapitalit të shoqërisë;

Znj. Entela MEHMETI, e bija e Zisi, e datëlindjes 19.10.1972, shtetase Shqiptare, banuese në Rr."Dalip Peza", Durres, Shqipëri, mbajtëse e Pasaportes Nr. BC3398329, Nr. Personal H26019072B, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e bashkëshortes së Shitësit;

meposhte bashkërisht referuar si "Shitësi"

PALA BLERËSE:

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA., me adresë të selisë qendrore në Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, hyrja 1, Njësia bashkiake 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri; themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Shqipëri sipas Vendimit Nr. 20830, datë 12 Shkurt 1999, me NIPT J91725007P, e përfaqësuar ligjërisht nga Anila Daci, e identifikuar me Letërnjoftimin Nr. 034140475, me Nr. Personal H45220062B, leshuar me 16 Prill 2019 nga MB, Shqiperi, sipas Rezolutes nr. 167, date 10.04.2025 të Aksionarit të Vetem;

meposhte referuar si "Blerësi"

OBJEKTI I KONTRATËS: Shitje e 1 (një) kuote e barazvlefshme me 10 % të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "**Premier Group**" sh.p.k., NUIS L51819501O (meposhte referuar si "Shoqëria"), me te drejte riblerje nga shitesi pas plotesimit të kushteve të percaktuara në këtë kontratë.

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

- A. **Shoqëria "Premier Group" sh.p.k. (NUIS L51819501O)**, me adresë "DURRES Lagjja nr.4, Rruga Hafiz Podgorica, zyra krah bankes greke, kati i parë", e regjistruar pranë QKB (Qendrës Kombëtare të Biznesit), me kapital të shoqërisë prej 363.135.431 lekë, dhe me ortakë Z. Enver Mehmeti zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 40% të kapitalit, Z. Agim Mehmeti zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 20% të kapitalit, Z. Arben Meçaj zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 20% të kapitalit dhe Z. Skënder Hysenaj zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 20% të kapitalit.



A2025053240086065742

- B. **Z. Enver Mehmeti** deklaron se nga kuota e tij në shoqëri (që përbëjnë një pjesë dhe 40% të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndër mend të shesë 1 (një) kuotë me vlerë 10% të kapitalit duke e lënë atë pronar të vetëm të 1 kuote me vlerë 30% të kapitalit;
- C. **Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.** ka shprehur vullnetin për të blerë kuotën me vlerë 10% të kapitalit duke e bërë atë pronar të 1 (një) kuote me vlerë 10% të kapitalit.
- D. Sipas konfirmimit të marrë nga RBS (Regjistri i Barrëve Siguruese), konfirmim që i bashkëlidhet kësaj kontrate, rrjedh se shoqëria nuk ka barrë siguruese apo detyrime të tjera ndaj të tretëve të siguruara me kuotën në pronësi të Enver Mehmeti;
- E. Ky veprim i shitblerjes së kuotave, sipas nenit 11 “Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit” të statutit të shoqërisë, mund të bëhet lirisht dhe nuk ka nevojë për tu miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë.

Neni 1

Objekti

- 1.1 Sot ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, **Z. Enver Mehmeti** shet dhe **Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.** ble 1 (një) kuotë në vlerën e 10% të kapitalit themeltar në shoqëri që zotërohej nga Shitësi.
- 1.2 Me blerjen nga Blerësi të kuotës në shitje nga Shitësi, Blerësi bëhet zotërues i 1 (një) kuote që përbën 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, që i korrespondon një vlere prej 36,313,543 lekë (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e trembedhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre leke) nga vlera totale e kapitalit themeltar të shoqërisë prej 363.135.431 (treqind e gjashtëdhjetë e tre milion e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë.
- 1.3 Blerësi fiton pronësinë mbi Kuotën dhe të gjitha të drejtat e lidhura me pronësinë mbi Kuotën në Shitje në datën e nënshkrimit. Blerësit i lind e drejta në datën e nënshkrimit të regjistrojë pronësinë e tij mbi kuotat në shitje në QKB, në librat e Shoqërisë dhe në çdo organ tjetër kompetent.

Neni 2

Cmimi i shitjes

- 2.1 Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën prej **36,313,543 lekë (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e trembedhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre leke)** i njohur si cmimi i shitjes.
- 2.2 Cmimi i shitjes së kuotave do t'i likujdhohet palës shitëse në numrin e llogarise bankare IBAN AL55210110120000000003577222 të mbajtur pranë Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a., nga Enver Mehmeti dhe bashkeshortja Entela Mehmeti brenda 7 (shtatë) dite pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe të Vendimit të Asamblese së Shoqërisë për ndryshimet në Statutin e saj dhe pasi Shitësi të bëhet ortak i 70% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- Në rast se nuk do të plotësohet kushti i sipërpermendur për kalimin e kuotave të reja të Enver Mehmeti, duke e bërë atë Ortak të Shumices me 70% minimalisht pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë brenda një periudhe 60 ditore nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, kjo kontrate perfundon dhe veprimet e kryera deri në atë moment për kalimin e Kuotes anulohen.

Neni 3

Transferimi i kuotës

- 3.1 E drejta e pronësisë së Shitësit mbi kuotën e Blerësit do të transferohet në favor të Blerësit në momentin e nënshkrimit të kontratës.



A2025053240086065742

- 3.2 Shitësit do t'i dorëzojë Blerësit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të përmbushur transferimin e kuotës në favor të Blerësit dhe për regjistrimin e këtij transaksioni në QKB.
- 3.3 Me transferimin e kuotës në pronësi të Blerësit, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. do të bëhet ortak e shoqërisë në zotërim të 1 (një) kuote që përbën 10% të kapitalit të shoqërisë.
- 3.4 Shitesi do të therrase jo më vonë se 7 dite pune nga data që do të bëhet Ortak i Shumices me minimalisht 70% të kapitalit të shoqërisë, Asamblene e Ortakeve të shoqërisë për të miratuar ndryshimet në Statut sipas Draft Statutit të rene dakord me tyre.
- 3.5 Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. nuk ka të drejtë ta shesë kuotën të asnjë pale e tretë të ndryshëm nga Shitesi, përveç rastit kur Shitesi nuk e ushtron të drejtën e Riblerjes së Kuotes brenda afatit të përcaktuar në Nenin 4, paragrafi 4.3. Me kalimin e këtij afati, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. gëzon të drejtën të shesë lirisht kuotat përkundërt çdo pale dhe pa asnjë kufizim në cmimin e shitjes së kuotes.

Neni 4

E drejta e Riblerjes së kuotes (Call-option i Shitesit)

- 4.1. Shitësi ka të drejtë të riblejë nga Blerësi, Kuotën e shitur me anë të kësaj kontrate, kuote e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë, pasi të plotësohen bashkërisht kushtet e mëposhtme:
- a) Totali i detyrimit të kredive aktuale dhe atyre të reja, që Shitesi Enver Mehmeti dhe/ose shoqëritë në pronësi të tij apo të lidhura në grup me të (Premier Group Shpk, ALBTOURS"D"-VAS tour operatore Shpk, Sunrise Beach Hotel Shpk, etj.), kanë apo do të marrin pranë Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a., do të ulët nën shumën 10,000,000 (dhjetë milion) Euro.
 - b) Kundërt Enver Mehmeti dhe/ose shoqërive në pronësi të tij apo të lidhura në grup me të (Premier Group Shpk, ALBTOURS"D"-VAS tour operatore Shpk, Sunrise Beach Hotel Shpk, etj.) nuk kanë filluar nga Banka Amerikane e Investimeve Sh.a., procedurat ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve sipas kontratave të kredive të lidhura me Bankën.
 - c) Të gjitha kushtet e dakordesuara në këto kontrate shitblerje kuotash, si dhe të gjitha kushtet e dakordesuara për ndryshimin e statutit të shoqërisë "Premier Group" Shpk, në qellim mbrojtjen e Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a. në cilësinë e Ortakut në Pakicë, janë përmbushur plotësisht nga Shitesi dhe Banka, në cilësinë e Ortakut nuk ka asnjë pretendim.
- 4.2. Palet dakordesojnë se Cmimi i Riblerjes së Kuotes nga Shitesi do të jetë 36,313,543 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) Leke, plus një normë interesi vjetore e përbërë nga Interesi i Bono Thesari 12 Mujore + 3.5%, minimumi 6% në vit. Norma baze "Interesi i Bono të Thesarit" është norma mesatare e ponderuar e titujve të Qeverisë Shqiptare me afat 12 mujor, që rezulton nga ankandi i fundit organizuar nga Banka e Shqipërisë, e publikuar në faqen: www.bankofalbania.org. Norma e interesit do të rishikohet nga Banka çdo vit, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 4.3. E drejta e Riblerjes duhet të të ushtrohet nga Shitesi brenda një periudhe 6 (gjashtë) mujore nga data e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në paragrafin 4.1 mësipër, por jo më vonë se data 30 Qershor 2031 (data e përfundimit të afatit për ushtrimin e të Drejtës së Riblerjes). Nëse Shitesi nuk e ushtron të Drejtën e Riblerjes brenda këtij afati Shitesi humbet të drejtën për të riblur Kuotën.



Neni 5

E drejta e Blerjes se Kuotave nga Bleresi (Call-option i Bleresit)

- 5.1. Nëse Shitësi nuk ushtron te Drejten e Riblerjes se Kuotes (Call – Option i Shitesit) brenda afatit te percaktuar ne nenin 4 mesiper, Blerësi, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a., ka të drejtën të kërkojë blerjen e te gjitha kuotave te kapitalit (call – option i Bleresit) ne pronesi te Shitesit Enver Mehmeti te shoqeria **Premier Group sh.p.k. (NUIS L518195010)**, duke u bere pronare e te gjitha kuotave qe zoterohen ne ate moment nga Shitesi Enver Mehmeti.
- 5.2. E drejta e Blerjes se Kuotave nga Bleresi (Call-option i Bleresit) do te ushtrohet nga Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. brenda 90 (nentedhjete) diteve pas perfundimit te afatit per ushtimin e te Drejtes se Riblerjes nga Shitesi (paragrafi 4.3 mesiper).
- 5.3. Ne rast se Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. e ushtron kete te drejte (call option i Bleresit), cmimi i blerjes se kuotave ne pronesi te Enver Mehmeti nga ana e Bankes, do te perlogaritet duke marre per baze cmimin e paguar sipas kesaj kontrate per blerjen e 1 Kuote qe perfageson 10% te kapitalit te shoqerise **Premier Group sh.p.k. (NUIS L518195010)**, dhe konkretisht cmimi do te jete: 36,313,543 (tridhjete e gjashte milion e treqind e trembedhjete mije e peseqind e dyzet e tre) Leke per cdo 10% te kuotave te kapitalit te zoteruara nga Shitesi Enver Mehmeti.

***Shembull:** Nese Enver Mehmeti ne momentin e ushtrimit nga Banka te kesaj te drejte ka ne pronesi 70% te kuotave te kapitalit, cmimi qe Banka do te paguaje do te jete:*

$$7 \times 36,313,543 \text{ Leke} = 254,194,801 \text{ Leke}$$

- 5.4. Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. do te njoftoje me shkrim Shitesin Enver Mehmeti per ushtimin nga ana e saj te te drejtes se Blerjes se Kuotave nga Bleresi, dhe brenda 30-diteve nga data e marrjes së njoftimit për ushtimin e kesaj te drejte nga Banka, Shitësi është i detyruar të transferojë kuotat ne favor te Bankes Amerikane te Investimeve Sh.a., duke nenshkuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem per kryerjen e ketij transferimi.

Neni 6

Shitja e kuotave te nje pale e trete nga Shitesi (Tag Along)

- 6.1. Nëse Shitesi vendos të shesë kuotat e tij te një palë e tretë apo ortak te shoqerise, ai duhet te njoftoje paraprakisht me shkrim Blerësin, i cili ka të drejtën të kërkojë nga Shitesi sa meposhte vijon:
- Shitesi te parapaguaje te gjitha detyrimet e kredise qe Enver Mehmeti dhe shoqerite e lidhura me te kane prane Bankes Amerikane te Investimeve Sh.a., dhe
 - Shitesi te riblerje kuotat ne pronesi te Bankes Amerikane te Investimeve Sh.a.me Cmimin e Riblerjes te dakordesuar ne kete kontrate.
- 6.2. Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. do te ushtroje te drejten e saj sipas paragrafit te mesiper, duke njoftuar Shitesin me shkrim, brenda nje afati 30 ditor nga data e marrjes dijeni per mundesine e shitjes se kuotave te nje pale e trete nga Shitesi.
- 6.3. Shitesi eshte i detyruar te plotesoje kerkesen e Bleresit njoftuar atij me shkrim sipas parashikimeve te ketij neni. Ne rast te kundert, Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. nuk do te lejoje dhe nuk do te jape pelqimin per tjetersimin e kuotave nga Enver Mehmeri ne favor te ndonje pale te trete apo ortaku te shoqerise dhe ka te drejte te ushtroje Call Option sipas Nenit 5 me siper ne kete Kontrate.



A2025033240086065742

Neni 7

Blerja e kredive

- 7.1 Nëse Shitesi do të transferojë apo do të bëjë buy-out kredite që Enver Mehmeti dhe dhe/ose shoqëritë në pronesi të tij apo të lidhura në grup me të (Premier Group Shpk, ALBTOURS"D"-VAS tour operatore Shpk, Sunrise Beach Hotel Shpk, etj.), kanë prane Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a., Shitesi ka detyrimin të kërkojë nga Blerësi Riblerjen e Kuotave të shoqërisë Premier Group Shpk me cmimin e dakordësuar në këto kontrata, përpara realizimit të Buy-out.
- 7.2 Riblerja e kuotave të shoqërisë duhet të përfundojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shlyerja totale e detyrimeve që Shitesi dhe shoqëritë e lidhura me të kanë prane Bankes. Në rast të kundërt, Shitesi humbet çdo të drejtë për të kërkuar nga Blerësi, Riblerjen e Kuotave me të njëjtin cmim, dhe Banka Amerikane e Investimeve Sh.a. zhvishet nga çdo detyrim kundër Shitesit apo çdo kufizim mbi të drejtat e saj si pronar i një kuote në masën 10% të kapitalit të shoqërisë Premier Group Shpk dhe ushtron të drejtën e call option sipas nenit 5 mësipër, si dhe Banka nuk miraton në çelësin e Ortakut, sipas kufizimeve statutore, transferimin ose buy out të kredive.

Neni 8

Detyrimet financiare

- 8.1 Palet dakordësojnë që çdo detyrim tatimor apo barre fiskale që mund të krijohet si pasojë e blerjes së kuotave nga Blerësi apo riblerjes së tyre nga Shitesi, apo si pasojë e ushtrimit të një të drejte apo përmbushjes së një detyrimi të percaktuar në këto kontrata, nga një apo të dyja palet bashkërisht, do të mbulohet nga Pala Shitesë dhe do të jetë në ngarkim të saj.
- 8.2 Të gjitha detyrimet financiare apo shpenzime që do të lindin si pasojë e përmbushjes së kësaj kontrate, ekzekutimit të saj, apo në lidhje me zbatimin e një ose me shumë detyrimeve që lindin prej saj, pavarësisht se nga cila palë shkaktohen, janë në ngarkim të Pales Shitesë.

Neni 9

Shkarkimi nga përgjegjësitë

- 9.1 Blerësi, në çelësin e Ortakut në pakicë do të jetë i liruar plotësisht nga çdo lloj përgjegjësie ligjore apo financiare, që mund të lind nga:
- a) Mashtrimi, evazioni fiskal apo çdo veprim i paligjshëm i kryer nga ortaku/ortaket e shumicës, administratori i Shoqërisë, apo çdo drejtues apo punonjës i saj.
 - b) Çdo shkelje ligjore apo kontraktuale ndaj palëve të treta, përfshirë detyrime ndaj furnitorëve, klientëve, apo institucioneve publike.
 - c) Çdo veprim ose mosveprim që krijon detyrime, apo ngarkon me përgjegjësi ligjore Shoqërinë.
- 9.2 Shitesi, në çelësin e Ortakut të Shumicës dhe Administratorit të shoqërisë, detyrohet të mbajë të pademtuar Blerësin dhe të mbulojë dhe të dëmshpërblejë Blerësin për çdo humbje, kosto ligjore, penalitete apo dëme financiare që mund të lindin si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të tyre gjatë drejtimit të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, përfshirë këtu edhe çdo dëm reputacional të shkaktuar si pasojë e veprimeve të parregullta apo të kryera në kundërshtim me ligjin nga Administratori/Ortaku i Shumicës së shoqërisë.



A2025053240086065742

Neni 10 Nenrenditja e detyrimeve

- 10.1 Çdo borxh apo detyrim i shoqërisë Premier Group Shpk ndaj ortakeve, përfshirë çdo kredi, financim ose huadhënie të bërë nga Shitesi/Ortaku i Shumices ndaj Shoqërisë, do të jetë i nenrenditur pas detyrimeve të kredive që Enver Mehmeti dhe dhe/ose shoqërite në pronësi të tij apo të lidhura në grup me të (Premier Group Shpk, ALBTOURS"D"-VAS tour operatore Shpk, Sunrise Beach Hotel Shpk, etj.), kanë pranë Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a..
- 10.2 Shoqëria dhe Ortaku i Shumicës nuk kanë të drejtë të ndryshojnë kushtet e borxhit të tyre pa miratimin paraprak të Blerësit (Bankës Amerikane të Investimeve Sh.a.). Çdo ndryshim i bërë pa këtë miratim do të jetë i pavlefshëm.

Neni 11 Përfaqësimet dhe Garancitë

- 11.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin për sa më poshtë vijon:
- Shitësi është pronar i vetëm i kuotës, objekt i kontratës sikurse vërtetohet nga ekstrakti i lëshuar nga QKB, bashkëlidhur kontratës dhe se nuk ka ndonjë pretendim nga ndonjë palë e tretë ndaj të drejtës së pronësisë mbi Kuotën, ekzistues apo të mundshëm.
 - Kuota është e lirë nga çdo peng apo barrë dhe Shitësi gëzon të drejtën, kompetencën dhe autoritetin e plotë për të transferuar Kuotën në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;
 - Shitësi ka të gjitha kompetencat për të nënshkruar dhe ekzekutuar këtë Kontratë dhe kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm të Shitësit, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e saj;
 - Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate nuk do të përbëjë shkelje të asnjë marrëveshje, kontrate ose detyrimi tjetër të marrë përsipër nga Shitësi;
 - Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate e shtrin fuqinë e saj ligjore dhe efektet e saj edhe mbi trashëgimtarët e Shitësit.
 - Shitësi humbet çdo të drejtë pronësie, për ndarje dividendi dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i kuotës së kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i Kuotës;
 - Shitesi merr përsipër që brenda një afati 45-ditor nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, të miratojë në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakeve të shoqërisë ndryshimet e statutit të shoqërisë sic është dakordësuar paraprakisht me shkrim midis paleve, dhe t'i depozitojë ato pranë QKB-se. Nëse ky afat nuk arrihet jo për faj të Shitësit, Blerësi mund të dakordësojë ta shtyjë këtë afat maksimumi për një periudhë shtesë 45-ditore. Në rast se nuk plotësohet ky detyrim as brenda afatit të ri, Shitesi do të konsiderohet se shkelje të detyrimeve të tij kontraktuale dhe humbet të drejtën e Riblerjes së Kuotave.
 - Shitesi Enver Mehmeti, në cilësinë e Ortakut dhe Administratorit të Shoqërisë deklaron se çdo informacion dhe dokumentacion i paraqitur pranë Bankes Amerikane të Investimeve Sh.a. në lidhje me gjendjen financiare dhe situatën ligjore të shoqërisë sipas Format Vetedeklarimi vëne në dispozicion Blerësit, është i plotë, i vërtetë dhe pasqyron situatën reale të shoqërisë.
 - Shitesi Enver Mehmeti, në cilësinë e Ortakut dhe Administratorit të Shoqërisë merr përsipër detyrimin të raportoje çdo vit pranë Blerësit, të dhëna financiare mbi performancën e shoqërisë Premier Group Shpk, si dhe të paraqesë raportet vjetore të audituara. Gjithashtu, çdo 6-muaj Blerësi do njoftohet mbi gjendjen e detyrimeve tatimore të shoqërisë sipas vërtetimit të lëshuar nga autoritet tatimore.



A2025053240086065742

- 11.2 Shitësi nuk është në kushtet e mospërbushjes së ndonjë marrëveshje në të cilën është palë e cila mund të ketë efekte negative mbi të drejtën e pronësisë mbi Kuotën objekt i kësaj kontrate.
- 11.3 Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin për sa më poshtë vijon:
- Nuk ka asnjë pengesë ligjore për lidhjen e kësaj Kontrate;
 - Se ka të gjitha kompetencat për të nënshkruar dhe përmbushur këtë Kontratë dhe kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm të Blerësit të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

Neni 12

Njoftimet

Cdo njoftim, aplikim, ose komunikim tjetër që duhet dhënë ose bërë sipas kësaj kontrate drejt Blerësit ose Shitësit do të bëhet me shkrim, në adresat përkatëse të secilës Palë. Shitësi pranon që të njoftohet edhe në adresën e selisë së shoqërisë Premier Group Shpk.

Neni 13

Veçueshmëria

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate, pjesërisht apo në tërësi, do të shfuqizohet apo do të bëhet e pazbatueshme nga gjykata ose autoritet tjetër kompetent, pjesa tjetër e dispozitave të pandikuara të kësaj Kontrate do të vazhdojë të jetë e vlefshme.

Neni 14

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 14.1 Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe përmbajtjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet miqësisht me mirëkuptim midis Palëve.
- 14.2 Nëse Palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, ato pranojnë juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 15

Tërësia e Marrëveshjes

- 15.1 Kontrata e lidhur mes Palëve përbën tërësinë e marrëveshjes dhe mirëkuptimin ndërmjet Palëve kontraktuese lidhur me objektin e saj.
- 15.2 Kjo Kontratë zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme dhe mirëkuptimet ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, të cilat do të pushojnë së ekzistuari ose të paturin ndonjë efekt apo forcë tjetër.
- 15.3 Kjo marrëveshje nuk mund të përfundohet në asnjë formë tjetër përveç asaj shkresore dhe çdo ndryshim i saj mund të kryhet vetëm me shkrim dhe të nënshkruhet nga Palët.

Neni 16

Ligji i Zbatueshëm

- 16.1 Kjo Kontratë, si dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin për Palët nga kjo Kontratë do të rregullohen, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 16.2 Kjo Kontratë, do të interpretohet duke mbajtur parasysh qëllimin e Palëve siç është shprehur në të.



A2025053240086065742

- 16.3 Secila nga kushtet e kësaj Kontrate interpretohet në mënyrën që mundëson realizimin e objektit të saj.
16.4 Titujt e neneve të kësaj Kontrate nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 17
Dispozita të Fundit

- 17.1 Palët deklarojnë dhe konfirmojnë që kjo Kontratë është lidhur me vullnetin e tyre të lirë dhe se ata janë në dijeni të pasojave ligjore që rrjedhin nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.
17.2 Kjo Kontratë përpilohet në 5 (pese) kopje origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore.

SHITËSI

ENVER MEHMETI
Enver Mehmeti

BASHKËSHORTJA

ENTELA MEHMETI
Entela Mehmeti

BLERËSI

Banka Amerikane e Investimeve Sh.a.

Anila Daci

Anila Daci

NOTERE

RIDVANA G. RUÇI



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	J91725007P			
2. Data e Regjistrimit	12/02/1999			
3. Emri i Subjektit	BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	12/02/1999			
6. Kohëzgjatja	Nga: 12/02/1999 Deri: 12/02/2098			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Hyrja 1, Njesia Bashkiake Nr, 10, Kodi Postar 1001			
8. Kapitali	3.450.934.674,69			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	3450934674.6900			
10. Numri i aksioneve:	84.769,00			
10.1 Vlera nominale:	40.709,87			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Natyra e aktiviteteve që do të kryhen nga Banka e cileson atë si Banke Universale. Banka do të kryejë veprimtaritë bankare sipas percaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" si dhe veprimtaritë financiare si me poshtë: Te gjitha format e kredidhenies, duke përfshirë edhe kredine konsumatore dhe kredine hipotekore; Qirane financiare; Te gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave: Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve; Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klienteve, qoftë dhe në një këmbim valutash, në një treg të veteorganizuar (OTC) ose ndryshe, si me poshtë:			

	instrumente te tregut te parase (ceqe, deftesa, certifikata te depozitave etj.); kembim valutor: Instrumente te kembimeve valutore dhe instrumente per vleresimin e normes se interesit, duke perfshire ketu produkte te tilla, si marreveshje swap dhe marreveshje qe percaktojne vleren e interesit ne te ardhmen: produkte derivative (instrumente derivative). duke perfshire, midis te tjerave, kontrata te se ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options); letra me vlere te transferueshme; instrumente te tjera te negociueshme dhe aktive financiare, duke perfshire veprimet me arin; pjesemarrjen dhe emetimin e te gjitha llojeve te letrave me vlere, duke perfshire nenshkrimin dhe vendosjen si agent (si publik ashtu edhe privat) dhe kryerjen e sherbimeve lidhur me keto emetime; Ofrimin e sherbimit te kasave te sigurimit; Ndermjetesimin per transaksionet monetare te meposhtme: administrimin e aktiveve te tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja ne kujdestari, sherbimet depozituese dhe te besimit; sherbimin per kompensimin dhe shlyerjen e pagesave te aktiveve financiare, duke perfshire letrat me vlere, produktet derivative dhe instrumente te tjera te negociueshme; sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar, si dhe perpunimin e te dhenave financiare e te programeve qe kane lidhje me te, nga furnizuesit e sherbimeve te tjera financiare.. Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare: Sherbimet keshilluese, ndermjetesese dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha veprimtarite e listuara nga nenpika 1 deri ne nenpiken 8 te ketij neni, duke perfshire referencen e kredise dhe te analizes, kerkimin dhe keshillimin ne lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe keshillimin mbi blerjet e mbi strategjine dhe ristrukturimin e shoqerive. Emetimin dhe administrimin e instrumenteve te pageses (te tilla si kartat e kreditit dhe te debitit, ceqet e udhetarit dhe ceqet bankare, kartat e pageses dhe pagesat me celular) etj., perfshire emetimin e parase elektronike.	
13. Sistemi i administrimit	☐ me një nivel ☒ me dy nivele	
14. Administratori/ët	Andi Ballta	
14.1 Afati i emërimit	Nga : 09/10/2024	Deri : 09/10/2027
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Edmond Coku	
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga : 01/06/2023	Deri : 01/06/2027
17. Anëtar i Pavarur	Po	
17.1 Përfaqesues i Punëmarrësve		

17.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
19. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Kathryn Barony Swintek
19.1 Kryetar/anëtar	Anetar
19.2 Afati i emërimit	Nga : 01/11/2024 Deri : 01/11/2028
20. Anëtar i Pavarur	Po
20.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.	
22. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele)	Ernst Rezzo Schlauch
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar
22.2 Afati i emërimit	Nga : 22/10/2023 Deri : 22/10/2027
23. Anëtar i Pavarur	Po
23.1 Përfaqesues i Punëmarrësve	
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes	
